

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**  
**NR. \_\_\_\_\_ PROT.**

Tirane, me 7. 4. 1999

**U R D H Ë R**

Nr. 28    Date

Sot me date 06.04.1999, unë Prokurori i Përgjithshëm Arben Rakipi, me qëllim për të evituar zbatimin e gabuar të ligjes procedurale penale, në bazë të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale

**URDHËROJ:**

1. Në rastet kur procedohet ndaj shtetasve të huaj, në gjendje arresti apo jo, pasaportat e tyre asnjëherë nuk duhen sekuestruar dhe mbajtur në prokurori, kujtoj që marrja e pasaportës apo dokumentit tjetër të identitetit, është mase shtrënguese në përputhje me nenin 233 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk mund të merret krahas një mase tjetër ndaluese apo shtrënguese.
2. Në rastet e mësipërme, pasaportat apo dokumentet e tjera të identitetit do të dërgohen menjëherë në Ministrinë tone të Punëve të Jashtme, që do të bëjë të mundur dërgimin në Ambasadat respektive.
3. Në asnjë rast pasaportat apo dokumentet e tjera të identifikimit të mos u jepen avokateve të interesuar apo të afërmeve të të pandehurve që paraqiten në prokurori. Pasaportat janë "prone e shtetit" dhe duhen trajtuar sipas pikës 2 të këtij urdhri.
4. Një kopje e këtij urdhri t'i drejtohet Ministrisë sonë të Jashtme për dijeni.
5. Shkelja e urdhrit përbën zbatim të gabuar të ligjit.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHEM**

**ARBEN RAKIPI**



